



Dr. Shefqet Krasniqi

Tirana pati festë. Filluan punimet për ndërtimin e Xhamisë së Madhe. Ishte një nga lajmet më të mira që kemi dëgjuar këto ditë. Të drejtat e mohuara për dekada, tanimë kanë filluar të përmbushen.

Muslimanët nuk do të detyrohen të kryejnë namazet e tyre nëpër rrugë. Ata do të kenë një Xhami, e cila, jo vetëm që do të përmbushë nevojat e hapësirës për falje, por do të jetë edhe një objekt që Tiranës do t'ia shtojë hijeshinë.

Xhamia e Madhe ka dhe një tjetër dimension. Ajo reflekton edhe pjekurinë e politikës shqiptare karshi të të drejtave. Ajo, siç do të shprehej edhe Lulzim Basha, reflekton edhe harmoninë fetare, pasi që besimtarëve, të të gjitha komuniteteve, po iu ofrohen kushte të barabarta për të kryer ritet dhe lutjet e tyre.

Funksioni i Xhamisë nuk është thjesht i një objekti kulturi për falje si adhurim ndaj Zotit. Ajo do të ketë natyrën e një qendre islame ku mendohet që të jenë edhe dy kate nën tokë për parkim, si dhe ambiente për aktivitete të tjera të natyrës kulturore e fetare. Kjo nënkupton se jeta fetare islame do të zhvillohet në formë institucionale dhe të moderuar.

Xhamia e Tiranës ka dhe një tjetër dimension, i cili është përtej Tiranës. Ajo vjen si një mësim për gatishmërinë që organet shtetërore duhet të tregojnë për të përmbushur obligimet karshi besimtarëve. Edhe neve në Kosovë na është ndarë parcela dhe janë prezantuar edhe projektet e mundshme për Xhaminë e Madhe në Prishtinë, por, thënë të drejtën, ajo është parë me më

skepticizëm dhe se fjalët prej skajeve e qosheve nuk kanë patur të ndalur kurrë.

Autoritetet tona duhet të avancojnë sa i përket çështjes fetare. Feja, sipas laicizmit të tyre, nuk ndërhyt në politikë, por ajo nuk duhet të përjashtohet nga shoqëria. Feja është thesari më i çmuar që e kemi. Organet tona shtetërore duhet të mendojnë për më shumë raporte me fenë, sidomos me këtë islame, që është feja e komunitetit më të madh në vend. Çështja e të drejtave tjera, shamisë me theks të veçantë, po kështu duhet të rregullohet. Kosova duhet të veprojë me logjikën e shteteve të përparuara që problemet i zgjidhin vetëm duke i përmbushur të drejtat themelore të qytetarëve të tyre.

Uroj që xhamia e nisur në Tiranë të përfundojë sa më parë, ashtu siç uroj që sa më parë të shoh edhe fillimin e ndërtimit të Xhamisë së Madhe në Prishtinë. E, pse jo, të jetë në një ditë të madhe, në Ramazan!